Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Sahit Beqiri	**17.07.2023**	**19.07.2023**	**2023/0478**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **10.07.2023**, GOE: **"Valdrini" sh.p.k; „Benita Company" Sh.p.k.,- Gllogoc**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0478**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE: **KOSOVA ASFALT SH.P.K.; Bujar Shabani B.I.; N.N.SH. WORLD MEDIUM - Ferizaj,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Lloti i I-re-Ndertimi,Asfaltimi dhe Rregullimi i rrugeve ne [Melenice,Stan Terg,Deg.e Magjistrales, Rr.Kopshti,Deg.Kuvendi i Lezhes]**" me nr. të prokurimit: "**642-23-3228-5-2-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **280,000.00 €.**Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë **NUK** është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L -042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L -237, Ligjin 05/L -068, dhe Ligjin 05/L -092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankese)

Pretendojmë se KUVENDI KOMUNAL MITROVICË, përmes Komisionit për vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të;

- Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i

referohemi LPP-së) dhe atë;

- Neni 1, Qëllimi, par 1, 2 dhe 3.
- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.
- Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe 4
- Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1
- Nenin 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, par 1.
- Nenit 72 të LPP-së, të Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, par 1 dhe 2.
- Nenin 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, par 8, nen par 8.4.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë: Neni 38, Sqarimi i Tenderëve, par 38.1

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Autoriteti Kontraktues, nuk e ka trajtuar siç duhet kërkesën për rishqyrtim, për me tepër akti administrativ i një vendimi është në kundërshtim me formën dhe përmbajtjen siç e përcaktojnë rregullat e përkatëse, sepse AK nuk ka nxjerre vendim, por ka nxjerrë qëndrim e që është në kundërshtim me përmbajtjen e aktit administrativ.

Madje arsyetimi i AK nuk është përmbajtjesor, nuk ka ofruar kundër argumente lidhur me pretendimet tona, për provat qe kanë qene pjese e dokumentacionit të dorëzuar me rastin e dorëzimit të tenderit, dhe tani të sqaruara edhe me foto në kërkesën për rishqyrtim, por ne mënyre diskriminuese, tendencioze dhe ne kundërshtim me nenin 108/A par 8, nen par 8.4 refuzon kërkesën pa i shqyrtuar siç duhet provat dhe pretendimet tona, prandaj, me te drejte e kundërshtojmë vendimin e AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sepse është nxjerrë në shkelje të Ligjit dhe jo ne argumentim të provave dhe, në tërësinë e tije Vendimi është i pa drejte, tendencioz, dhe diskriminues ndaj konsorciumit tonë.

Ne vijim do ti trajtojmë pretendimet tona ne ANKESË duke e kundërshtuar :

Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 06.06.2023;

Vendimi i AK, për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerrë në shkelje të LPP-se, përkatësisht nenit 108/A, par 8, nen par 8.4 të LPP-se, sepse nuk i ka trajtuar pretendimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, madje i ka shtrembëruar provat lidhur dhe dëshmitë bindëse të cilat janë pjese e dokumentacionit të dorëzuar nga ana jonë dhe të cilat kanë qenë ne pajtueshmëri të plotë me kriteret e përzgjedhjes të parapara ne NJK dhe DT.

Ne vijim paraqesim arsyetimin e AK-së, ne refuzim të kërkesës për rishqyrtim, për secilën pike veç e veç duke e trajtuar, ekzaminuar dhe krahasuar trajtimin jo te duhur te pretendimeve tona, dëshmive të dokumentuara dhe trajtimin jo të barabartë dhe të pa drejtë ndaj konsorciumit tonë nga ana e AK:

E para: Arsyetimi i AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim sa i përket ANEXI 7 Lista e pajisjeve te DT pika 9.1 dhe 9.2, Poz. 7. **Frez asfalti 0-4 ton**, me arsyetimin se:

Ne kemi verifikuar përsëri sipas faturës se dorëzuar herën e I-rë se VITAX V3 nuk ka si të del ndryshe por e njëjta pajisje tash ju na ofroni tjetër pajisje tjetër faturë dhe i ofroni fotot tjera ku herën e I-rë nuk ishin fare, kërkojmë falje por nuk është e pranueshme as nga Komisioni as nga

Zyra e Prokurimit .

Neni 72 i LPP-së sqaron shumë qartë edhe pse ne duke u bazuar ne ofertën e juaj dhe duke u bazuar në dokumentet e juaja te ofruara ne ofertën e juaj, vetë neni 59 dhe 71 nuk na ka lejuar te kërkojmë dokumente shtesë sepse ju i keni ofruar në ofertë por nuk kanë qenë sipas specifikave te kërkuara .

Përgjigjja dhe Arsyetimi i AK në pretendimet tona, është i pa pranueshëm, sepse pretendimi ynë ka qene që Komisioni për vlerësim ekzaminim dhe krahasim të tenderëve nuk i ka ekzaminuar siç duhet dhe sa duhet dokumentacionin e GOE ''VALDRINI SH.P.K & "BENITA COMPANY" SHPK, ngase konsorciumi ynë me rastin e dorëzimit të tenderit, sipas kërkesës se AK, ka bashkangjitur edhe dëshmitë bindëse sa i përket Poz. 7.**Frez asfalti 0-4 ton**,

Faktet e rastit:

Kërkesa: 7. Lista e pajisjeve, mjeteve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 7, është kërkuar (**Frez asfaltit 0-4 ton**).

Dëshmia: 7. Të dhënat për pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje ! Në rast se O.E.nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Ne rastin konkret, AK në DT, të kriteret e përzgjedhjes ka kërkuar **Frezë asfalti prej zero (0) Ton deri në katër (4) ton**, kurse ne kemi ofruar pajisjen dhe dëshminë bindëse sipas faturës 42/2023, që është relevante dhe në përputhje të plotë me kriteret e përzgjedhjes, sepse AK në NJK dhe DT, ka parapa vetë tolerancën e pajisjes, duke filluar nga zero deri ne katër Ton dhe, ne ketë rast konsorciumi yne ka ofruar pajisjen 0.15t ose 150kg, e që është në përputhje të plotë kriteret e përzgjedhjes, për me tepër edhe ne përputhje te plotë me aktivitetin e prokurimit, me qe rast edhe vet AK e ka konstatuar ketë fakt, se dëshmia për pajisjen e tillë është dorëzuar me rastin e dorëzimit të dosjes së tenderit.

Madje, AK, në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, tenton të shtrembëroj faktet e rastit, kinse ne kemi ofruar tjetër pajisje dhe tjetër faturë, e që nuk është e vërtet dhe nuk qëndron ky arsyetim i AK, sepse kemi të bëjmë me te njëjtën pajisje dhe me te njëjtën faturë.

Mirëpo, AK nuk i ka shfrytëzuar dispozitat e nenit 59, par 2 dhe nenit 72, par 1 te LPP-se dhe nenit 38, par 38.1 e RRPP, për të kërkuar informata sqaruese, sepse, atu ku për AK është e pa qartë, mund të kërkoj informata sqaruese, ngase është në pyetje ruajtja e buxhetit dhe vlera për para.

Prandaj, përderisa AK, na eliminonin nga Aktiviteti i mëtejme i prokurimit pa kërkuar sqarime shtese lidhur me dëshmitë e lartë cekura, atëherë në kërkesën për rishqyrtim, kërkesës në fjalë u kemi bashkangjitur edhe fotot që janë të pajisjes përkatëse, për me tepër është një e pa vërtet e madhe e AK, ku pretendon se janë dokumente tjera!

Provë: provë fatura nr.42/2023 e datës 13.02.2023

Është jo profesionale dhe jo etike nga ana e AK, që për pajisjen ne fjalë ti referohet CODIT të pajisjes, kur është PËRSHKRIMI, sepse codet ne faturë janë te personalizuara dhe fare nuk ka të beje me atë që

AK ka gjurmuar përmes internetit-google, ngase këto veprime të AK bien ndesh edhe me dispozitat e nenit 97, par 97.1, nen par (d) dhe (o) të RrPP, për shkak të mosrespektim të parimeve themelore, sa i përket trajtimit të barabar të OE dhe sjelljeve jo profesionale dhe të tërësisht të gabuara.

Prandaj, pretendimet e AK për te eliminuar konsorciumin tonë nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit janë të pa qëndrueshme, të pa drejta, tendencioze dhe në shkelje të dispozitave të nenit 59, par 4 të LPP-së dhe në shkelje të nenit 40, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a;b dhe c, të Rregullores 01_2022 të KRPP-së, për faktin se, tani ne ketë fazë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve aplikon kritere tjera në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT, sepse GOE "'VALDRINI SH.P.K & "BENITA COMPANY" SHPK, i ka plotësuar në tersi kriteret e përzgjedhës të paraparë nga AK në NJK dhe DT, ngase provat janë argumenti me i fuqishëm që dëshmojnë faktin e rastit, si ne rastin konkret, që dëshmia-prova për pajisjet në fjalë është e pa kontestuar.

Ju konfirmojmë se ne së bashku me Komisionin e vlerësimit duke shqyrtuar përsëri ofertën e juaj dhe dokumentacionin e ofruar, edhe pse ne nuk e kemi kërkuar kurrfarë dokumenti edhe dokumentacionin e pranuar se bashku me kërkesën për Rishqyrtim [si dokumentacion shtesë edhe pse ne nuk ju kemi kërkuar sqarime shtesë për-nuk na lejon neni 59-71 për kërkesa shtesë në rastin konkret te juaj in] për arsye se dokumentacioni për kriteret e kërkuara ka ekzistuar mirëpo nuk i ka plotësuar parakushtet dhe specifikat e kërkuara te pajisjeve ne duke analizuar dhe shqyrtuar e gjithë ofertën paraprake dhe dokumentet e ofruara nga ju me keqardhje ju njoftuam se NUK MUND ta pranojmë kërkesën e juaj për RISHQYRTIM si te bazuar me arsyetimin se ju në kërkesën e juaj per RISHQYRTIM dokumentet e ofruara janë dokumente krejt tjera dhe automatikisht oferta dhe pajisjet e juaja te ofruara herën e parë dhe dokumentet përsëri të dorëzuara janë dokumente shtesë te cilat dokumente nuk kanë qenë në ofertën e juaj herën e I-rë.

Neni 72 i LPP-së sqaron shumë qartë edhe pse ne duke u bazuar ne ofertën e juaj dhe duke u bazuar në dokumentet e juaja te ofruara ne ofertën e juaj, vetë neni 59 dhe 71 nuk na ka lejuar te kërkojmë dokumente shtesë sepse ju i keni ofruar në ofertë por nuk kanë qenë sipas specifikave te kërkuara .

Nëse ne si zyre e Prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit pranojmë dokumente shtesë tjera per dokumentet ekzistuese atëherë do ti humbte kuptimi ofertimit afateve dhe ofertave dhe nuk do te ishte kurrfarë ofertimi transparent dhe do ti humbte edhe vlera e ofertimit me anë te Procedurave te Prokurimit.

Neni 72 i LPP-së përcakton shumë qartë se çfarë dokumenti dhe sqarimi mund te ofrohet pas vlerësimit te ofertave ose gjatë vlerësimit citoj:

Po ashtu edhe në pretendimin e dytë, përgjigjja dhe Arsyetimi i AK, është i pa pranueshëm, sepse pretendimi ynë ka qene që Komisioni për vlerësim ekzaminim dhe krahasim të tenderëve nuk i ka ekzaminuar siç duhet dhe sa duhet dokumentacionin e GOE ''VALDRINI SH.P.K & "BENITA COMPANY" SHPK, ngase, konsorciumi ynë me rastin e dorëzimit të tenderit, sipas kërkesës se AK, ka bashkangjitur edhe dëshmitë bindëse sa i përket, **Poz. 8. Spërkatës për Bitumen dhe Emolzion,**

Faktet e rastit:

Kërkesa: 7. Lista e pajisjeve, mjeteve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 7, është kërkuar **(Sperkates per Bitumen dhe Emulizion**).

Dëshmia: 7. Të dhënat për pajisjet Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e

regjistrimit, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje ! Në rast se O.E.nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Edhe në rastin konkret, AK në DT, të kriteret e përzgjedhjes ka kërkuar **Sperkates per Bitumen dhe Emulizion**, kurse ne kemi ofruar pajisjen dhe dëshminë bindëse sipas faturës 2000145-10, të datës 24.06.2010, e zhdoganuar në Kosovë me 02.07.2010, me targa :03-125-GI, për të cilën kemi marrëveshje për shfrytëzim me qira të noterizuar , sipas kritereve të përzgjedhjes dhe që është relevante dhe në përputhje të plotë me kriteret e përzgjedhjes

Provë: Fatura nr.2000145-10 e datës 24.06.2023, me targa :03-125-GI

AK, na eliminon nga aktiviteti i prokurimit, kinse pajisja e ofruar nga ne është vetëm Kamion për Pastrim e rrugëve dhe nuk është sipas kërkesave të AK, por e vërteta qëndron ndryshe, sepse, AK nuk e vlerëson, ekzaminon dhe krahason dosjen tonë në përputhje me dispozitat e Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe 4, për faktin se nuk i referohet burimit te informacionit siç është fatura dhe përshkrimit në faturë, por i referohet librezës së regjistrimit dhe cilësimit të Autoriteti Doganor ne kohen kur pajisja në fjalë është importuar, por pajisja në fjalë, përveç që benë pastrimin e rrugës nga pjesa e përparme, pajisja ne fjalë ne pjesën e pasme ka të integruar spërkatësen për Bitumen dhe Emulizion është në përputhje të plotë me kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT, për me tepër po sqarojmë edhe një herë përshkrimin adekuat sipas faturës ose burimit të informacionit në gjuhen origjinale dhe të përkthyer, ashtu siç e kemi prezantuar edhe në kërkesën për rishqyrtim: **Naprava brizganje bitumna in ostalih veziv, rezervoar 2000 l" në shqip, "Paisje për spërkatje të bitumit dhe lidhësve të tjerë, rezervuari 2000 l".**

Prandaj, tendencat e AK për ti dhëne arsyetim tjetër pajisjes në fjalë është i pa drejte dhe tendencioz, sepse kamioni me targat 03-125-GI e ka te integruar, pajisjen përkatëse sipas kërkesave të DT.

Madje, të dy pajisjet e lartë cekura, për veç qe janë të dëshmuara me ane te faturave, ato mund të vërtetohen edhe ne fizikisht që janë mjete pune për qëllimin relevant të aktivitetit në fjalë dhe që janë në përputhje të plotë me kriteret e përzgjedhjes të parapara nga AK.

Për me tepër arsyetimi i AK se nuk e lejojnë dispozitat e nenit 59 dhe 71 është i pa pranueshëm dhe në interpretim të gabuar dhe jo të drejtë, sepse ekzistenca e të dy dokumenteve-dëshmive të lartë cekura ka qene pjese dosjes së tenderit me rastin e dorëzimit të ofertave dhe, në rastin konkret AK duhet të shfrytëzoj dispozitat e nenit 72 për të kërkuar informata për sqarime shtese, sepse marrë parasysh natyrën e punëve dhe funksionimin e pajisjes për qëllimin relevant të aktivitetit, këto pajisje plotësojnë në tersi kërkesat e AK të parapara në NJK dhe DT dhe në përputhje të plotë me nenin 69, par 1 të LPP-së.

Pra, në rastin konkret, kur ka pa qartësi apo nevojë për informata shtese apo te ngjashme dhe, kur është ne pyetje ruajtja e buxhetit duhet te ketë parasysh nenin 1 Qëllimi, Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasitetin dhe, mbi bazën e këtyre parimeve themelore të LPP-se dhe, për të ruajtur buxhetin, duhet të kërkoj informata sqaruese, sepse neni 59, par 2, neni 72 par 72.1 të LPP-se dhe neni 38, par 38.1 i

RRPP i lejojnë AK që të kërkoj informata sqaruese ne mënyre që vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në përputhje të plotë kriteret e përzgjedhjes të parapara ne NJK dhe të DT.

Kurse, **sa i përket njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te papërgjegjshëm-eleminuar) nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit dhe Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 30.06.2023**, qëndrojmë prapa kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar në AK të cilën e kemi argumentuar me foto dhe dëshmi bindëse dhe e cila është pjese e bashkangjitur në ketë ankesë, por, prapë edhe me anë të kësaj ankese pretendojmë se AK në kundërshtim te plotë me nenin 56, par 1, nen par 1.1 dhe 1.2 dhe nenit 60, par 1, nen par 1.1, e LPP-se, shpërblen me kontratë për Lot 1: GOE **"Quality Asphalt" shpk & "Enggroup" shpk,** Ferizaj edhe pse janë me çmimi me të lartë, ne krahasim me Ofertën tonë, ne kundërshtim të plotë me kriteret e vlerësimit të parapara në njoftim për kontratë dhe Dosje të tenderit, sepse kriter i vlerësimit ka qene **Oferta e përgjegjshme me çmimin me te ulët.**

Për me tepër, me ketë vendim, AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1, par 1 dhe 3; nenin 6, par 1 të LPP-se, sepse, nëse i referohemi Vendimit te Autoritetit kontraktues do të shohim se, çmimi i ofertuar i ofertës së GOE **"Valdrini Sh.P.K & "Benita Company" Shpk** është **267,990.00€** dhe, është çmimi me i ulte ne raport me çmimin e GOE **"Quality Asphalt" shpk & "Enggroup" shpk**, Ferizaj të propozuar për kontrate ne vlere prej **276,380.45€,** me që rast, Autoriteti kontraktues me ketë veprim dëmton buxhetin varfër e Republikës se Kosovës dhe te KOMUNËS në veçanti, i cili buxhet përbehet nga taksat e qytetareve te Republikës së Kosovës dhe, demi që do të shkaktohet është ne shume prej **8,390.45Euro.**

Me ketë veprim, AK ka tejkaluar kompetencat ligjore dhe në shkelje të dispozitave të lartë cekura, sepse e dëmton rënd Buxhetin e Republikës së Kosovës, ngase AK në NJK dhe DT, kriter i dhënies ka qenë tenderi me **çmimin me te ulët!.**

Prandaj, pretendimet tona sa i përket dispozitave ligjore të shkelura nga AK qëndrojnë sepse janë ta bazuara dhe te argumentuara dhe të mbështetura në Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren dhe udhëzuesin e prokurimit publik..

Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga **OSHP-ja**, që Ankesën ta trajtoj ne pajtueshmëri më dispozitat ligjore të LPP-se, ta trajtoj ne pajtueshmëri të plotë me kërkesat e parapara ne njoftim për kontratë dhe dosjes së tenderit SI DHE TË KETË NË KONSIDERATË VLEREN PËR PARA, SEPSE KY ËSHTË EDHE QËLLIMI I LPP-së.

Duke u bazuar në faktet, argumentet, arsyetimet, provat materiale, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që pas trajtimit të ankesës tonë të nxjerr:

VENDIM

Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovoj ANKESEN të bazuar të paraqitur nga **GOE "Valdriniü Sh.P.K & "Benita Company" Shpk.**

Te anuloj vendimin e AK – KOMUNËS SË MITROVICËS, për refuzim të kërkesës për Ri-shqyrtim, sepse **GOE "Valdrini Sh.P.K & "Benita Company" Shpk**., ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Te kthej rastin ne Ri-Vlerësim dhe vlerësimi të behet me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm që ka dorëzuar çmimin më të ulët.

Të trajtoj ankesën drejtë, pasi që jemi pale me interes juridiko material dhe kandidat te vetëm potencial për të fituar këtë llot-pjesë sipas LPP-së dhe rregullave tjera ligjore në fuqi.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), nuk janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues pasi qe OE ankues ka larguar/hequr nenin 40 pika 1 dhe 12 e Rregullores 001/2022, kurse ka shtuar nenin 72 i LPP-së dhe nenin 38 i Rregullores 001/2022 sqarimi i tenderëve par. 38.1 si dhe Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – nuk janë te njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, pa ka ndryshuar/plotësuar mirëpo janë ruajt pretendimet ankimore lidhur me këtë aktivitet te prokurimit.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional **Dëshmia e kërkuar dokumentar.**

Kërkesa 7]. Lista e pajisjeve, mjeteve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 7.	**Deshmia 7]. Të dhënat për pajisjet Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje ! Në rast se O.E. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.**

Aneksi 7.LISTA E PAJISJEVE-Lloti i II-të-IV: PAJISJET DHE MEKANIZIMI I NEVOJSHËM.

N.R	**Përshkrimi i pajisjes**	**Sasia minimale (copë)**	**Sasia që ofron ofertuesi**	**Të dhënat për pajisjet - Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).**
1	**Eskavator me peshë minimum15 T dhe maksimum 48 T**	2		

2	**Lugë ngarkuese me peshë minimum 15 T dhe maksimum 29 T**	1		
3	**Kamion kapacitet 10 m³ kiper.**	3		
4	**Finisher per shtruarje te asfaltit**	1		
5	**Cilinder asfalti Gomë-Hekur dhe Hekur Hekur 4-15 ton**	1		
6	**Cistern e ujit**	1		
7	**Sperkates per Bitumen dhe Emulizion**	1		

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Grupi i Operatoreve Ekonomik Valdrini sh.p.k.; "Benita Company Sh.p.k. nuk i plotësojnë kriteret e pikës 9.1 dhe 9.2 te kriteret teknike/profesionale te pajisjet i ka dorëzuar pajisjet mirëpo pajisjet e dorëzuara nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara sipas DT por ka dorëzuar pajisje tjera te cilat nuk janë pajisjet e kërkuara.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Valdrini sh.p.k**

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1 dhe 2

Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 60 pasi që ka eliminuar ofertën tonë për arsye që nuk është plotësuar kriteret e pikës 9.1 & 9.2 të FDT-së, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, lidhur me pajisjet e dorëzuara nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara sipas DT-së,por ka dorëzuar pajisje tjera të cilat nuk janë pajisje të kërkuara ne Aneksin 7 te dosjes se tenderit; **Poz. 7.Frez asfalti 0-4 ton,** si dhe **Poz. 8. Spërkatës për Bitumen dhe Emolzion,**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si ne aneksin 7 te dosjes se tenderit (*shiko kriteret e vlerësimit në këtë raport si më lartë*), GOE ankues ka prezantuar listën e pajisjeve duke plotësuar aneksin 7 te FDT-se, duke dhëne sqarime te kolona te "dhënat per pajisjet" te nënshkruar dhe vulosur, duke ju bashkangjitur librezën e qarkullimit, faturën, duke ofruar baze per sqarime shtesë për të konstatuar dhe vërtetuar se OE ankues plotëson kërkesat teknik dhe/ose profesional të FDT-së, pasi që kërkesa ne dosje te tenderit po citoj: ***"OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).",***andaj duke u bazuar ne analizën si më lartë, arsyetimin e ZPP në kërkesën për rishqyrtim, AK – Komisionit të vlerësimit, duke siguruar se këto dy pajisje te ofruara nga OE janë komplementar dhe arrijnë te plotësojnë aneksin 7 të FDT-së, kanë qenë të obliguar të veproj duke marr për bazë **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**.

Gjithashtu,**Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues përmes platformës elektronike e-prokurim ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me date 30.06.2023, kurse ZPP me date 03.07.2023 përmes platformës elektronike e-prokurim nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke vepruar ne pajtim te plotë me **nenin 108/A par. 9 te LPP-se**, ku thotë: "*Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë."* si dhe **nenin 108/A par. 12 te LPP-se, ku thotë:** *Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë",* mirëpo bazuar ne arsyetimet e eliminimit nga ZPP ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës per rishqyrti (si dhe sqarimet e dhëna nga komisioni i vlerësimit ne raportin e vlerësimit, arsyet e leminimit ne letrën standarde te eleminimit), nuk jane bindëse dhe as te argumentuar ne gjuhen e fakteve dhe argumenteve - provave apo te bazuar ne dispozita ligjore te LPP-se, por me shume i ngjanë nje arsyetimi filozofik dhe abstrakt, duke mos arritur te argumentohet pse këto pajisje te ofruar nga GOE nuk janë sipas dosjes se tenderit me fakte dhe argument konkrete dhe bindëse, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur as nga komisioni i vlerësimit ne raportin e tij dhe as ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga

ZPP, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **janë të qëndrueshëm.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60, 72 të LPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe Aneksin 7 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**, (*për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë*) dhe rekomandon që të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (*vendimit për dhënie të kontratës*) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Valdrini sh.p.k**

Sahit Beqiri

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA